

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTER
KËSHILLI BASHKIAK

(Adresa, _____ nr. Tel _____, e-mail _____)

Komisioni i Përhershëm i Financave, Buxhetit , Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit
Strategjik

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 01 Datë 29/05/2026

Nr _____ Prot

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. _____ datë _2026, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin **“Për përcaktimin e elementëve të pagës bruto për strukturën e policisë bashkiake gjirokastër”**

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

Mbështetur në nenin 54, shkronja k, neni 64, e ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjin nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore, ligjin nr 35/2023 “Për kompetencat për përcaktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, ligjin nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, VKM-në nr. 328, datë 31.05.2023, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekte page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, ndryshuar, Vendimin nr. 452, datë 26.07.2023 “Për miratimin e rregullores kuadër të Policisë Bashkiake”, Udhëzimin nr 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, VKB-në nr.101, datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026” i ndryshuar, VKB-në nr. 23, datë 30.03.2026 “Për një ndryshim të pikës 2, të VKB-së nr. 92, datë 22.12.2025 “Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të Bashkisë Gjirokastër për vitin 2026”.

Situata aktuale e funksionit

Neni 28, të ligjit nr. 89/2022 "Për Policinë Bashkiake", citon; *"1. Paga e punonjësit të Policisë Bashkiake miratohet nga Këshilli Bashkiak në përputhje me legjislacionin në fuqi për pagat dhe shpërblimet. 2. Shpenzimet për pagat dhe shpenzimet e tjera përballohen nga buxheti i bashkisë"*.

Neni 5, të ligjit nr. 35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", citon;

"Në përcaktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në sektorin publik, institucionet dhe organet duhet të garantojnë shpërblimin e drejtë dhe dinjitoz të tyre, duke siguruar që institucionet/entet publike:

- a) të jenë në gjendje të marrin në punë persona të motivuar dhe që përmbushin me shpejtësi dhe cilësi funksionet e tyre;*
- b) të motivojnë të punësuarit nëpërmjet skemave të posaçme që të rrisin performancën në punë;*
- c) të sigurojnë një shpërblim të drejtë dhe të barabartë për punë të njëjta;*
- ç) të krijohet një sistem pagash, trajtimesh të tjera financiare dhe përfitimesh, që mund t'i përgjigjet nevojës për të përmbushur prioritetet;*
- d) të jenë në gjendje të konkurrojnë me sektorin privat për punësimin e punonjësve të talentuar.*

Neni 9, shkronja d, të ligjit 35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi" citon; *"Këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore miratojnë; pagat e punonjësve të njësive ekonomike dhe të institucioneve të varësisë së tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi, me përjashtim të rasteve, kur me ligj të veçantë, është parashikuar ndryshe;"*

Neni 10, të VKM-së nr. 328, datë 31.05.2023, "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekte page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", citon; *"Këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore miratojnë pagat e punonjësve të njësive ekonomike dhe të institucioneve të varësisë, me përjashtim të rasteve, kur me ligj, është parashikuar ndryshe, duke respektuar hierarkinë e pagave të nëpunësve apo punonjësve të bashkisë përkatëse;"*

Situata financiare:

Në kontekstin e ligjit si më lartë cituar elementët përbërës të pagës bruto mujore për strukturën e Policisë Bashkiake do të jenë; a) Paga bazë për klasë, që shpërblen vlerën relative të çdo pozicioni pune, të miratuar me VKB nr. 23, datë 30.03.2026 "Për një ndryshim të pikës 2, të VKB-së nr. 92, datë 22.12.2025 "Për

miratimin e numrit maksimal ë punonjësve dhe nivelit të pagave të Bashkisë Gjirokastër për vitin 2026”, b) Shtesa për vjetësi në punë, të jepet në masën 1 (një) përqind të pagës bazë për klasë.

Drejtoria / Sektori përgjegjës

Drejtoria e Financës

Monitorimi dhe raportimi: (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh)

Komisioni i Përhershëm i Financave, Buxhetit , Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik keshilli bashkiak, sa here qe ai e shikon te nevojshme

Impakti social / grupet që preken: Punonjesit e Policise Bashkiake Gjirokaster.

A është objekt i konsultimit publik: jo

Komisioni i Përhershëm i “Financave, Buxhetit , Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik”, i mbledhur me datën 29/05/2026, shqyrtoi projekt vendimit nr. ___ datë _____ 2026, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin “Për përcaktimin e elementëve të pagës bruto për strukturën e policisë bashkiake gjirokastër”

paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni e me shumicë votash:

VENDOSI

1. T’i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit
- c) refuzimin e miratimit të projektaktit
- d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:
 - ✓ Pika 1 (një) e projekt vendimit të ndryshoje në “-----“

- ✓ Pika 4 (katër) e projekt vendimit të ndryshoje në "-----"
- ✓ Tabela nr. 6 (gjashtë) e projekt vendimit të ndryshoje në "-----"
- ✓ Paragrafi 15 (pesëmbëdhjetë) i projekt vendimit të ndryshoje në "-----"

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në proçesverbalin e mbledhjes së Komisionit

_____ **Kryetar i Komisionit**

(emri, mbiemri, firma)

_____ **Sekretar i Komisionit**

(emri, mbiemri, firma)

